Pa. nr. 08-112

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga AEKUH38 GmbH, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me adresë afariste në Gabrielenstraße 9, 80636 Munih, Gjermani, nëpërmjet Darko Konstantinoviq, avokat nga Shoqëria e Avokatëve Konstantinoviq dhe Miloshevski nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 17.08.2026, miratoi këtë:

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi, me të cilin AEKUH38 GmbH, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me adresë afariste në Gabrielenstraße 9, 80636 Munih, Gjermani, synon të fitojë kontrollin e vetëm mbi SABIC Europe B.V., shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, me seli të regjistruar në Sittard, Holandë, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi dhe programi i të ardhurave 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vijim: Ligji), më datë 17.07.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës u dorëzua njoftimi për përqendrim nga AEKUH38 GmbH, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me adresë afariste në Gabrielenstraße 9, 80636 Munih, Gjermani, me të cilin AEKUH38 GmbH synon të fitojë kontrollin e vetëm mbi SABIC Europe B.V., shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, me seli të regjistruar në Sittard, Holandë.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në njoftimin për përqendrim dhe dokumentacionit të bashkëngjitur, konstatoi sa vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira

AEKUH38 GmbH është shoqëri e varur, në pronësi të plotë të AEQUITA SE & Co. KGaA, dhe vepron si shoqëri e saj për qëllime të veçanta (SPV).

Veprimtaritë afariste të AEQUITA SE & Co. KGaA konsistojnë në investime në situata të veçanta, siç janë ndarjet në grup, trashëgimitë dhe situatat e ristrukturimit.

Transaksioni ka të bëjë me prodhimin dhe furnizimin e olefinave, poliolefinave dhe përbërjeve të tyre.

Brenda Grupit të AEKUH38 GmbH nuk ka kompani të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Grupi i AEKUH38 GmbH ka realizuar të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga shitja e kompanive të portofolit të tij, Dürkopp (prodhues i kushinetave me gjilpëra dhe komponentëve përkatës) dhe TMD Friction (prodhues ndërkombëtar i specializuar në prodhimin e sistemeve të frenimit për lloje të ndryshme automjetesh, siç janë veturat e udhëtarëve, automjetet komerciale dhe motoçikletat).

Në momentin e paraqitjes së njoftimit, AEKUH38 GmbH nuk është e pranishme në tregjet përkatëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut, as nëpërmjet pranisë korporative dhe as nëpërmjet importit të produkteve përkatëse.

SABIC Europe B.V. është shoqëri e varur, në pronësi të plotë të SABIC International Holdings B.V. SABIC International Holdings B.V. është shoqëri e varur, në pronësi të plotë të Saudi Basic Industries Corporation („**SABIC**"), kompani globale e prodhimit të produkteve kimike, me seli në Arabinë Saudite.

SABIC Europe B.V. është e pranishme në tregun përkatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet importit të poliolefinave në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht PE – polietilenit dhe PP – polipropilenit.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës,* vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:
Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE
Mr. Малинка Силјановска Николиќ